



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

FAKULTETI I INXHNIERISË MEKANIKE

Rruga Agim Ramadani, Ndërtesa e Fakulteteve Teknike, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: +383 38 552 126 ext. 101 * E-mail: fim@uni-pr.edu * www.fim.uni-pr.eduNr. Prot.: 2470
Date: 26/12/2025

RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

FAKULTETI	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
Departamenti/Programi	Departamenti i Komunikacionit / Komunikacion rrugor
Titulli i punimit	“Analiza e efikasitetit të operacioneve në portet detare dhe ndikimi i tyre në zinxhirin e furnizimit – Studim rasti: Porti i Durrësit”
Kandidati	<i>Bsc Rinor Halimi</i>
Mentori	<i>Prof. asoc. Arlinda Rrecaj</i>
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: <i>30.06.2025</i> Vendimi Nr. : <i>1038</i>

Vlerësimi i dorëshkrimit.

Punim me titull **“Analiza e efikasitetit të operacioneve në portet detare dhe ndikimi i tyre në zinxhirin e furnizimit – Studim rasti: Porti i Durrësit”**, i kandidatit Rinor Halimi, është punuar në gjithsej 63 faqe tekst të formatit A4, në vazhdim të së cilës është dhënë deklarata e studentit për punë autentike. Në kuadër të tekstit janë përfshirë 42 figura. Punimi është strukturuar në 7 kapituj, me përfundimin me përmbledhje, bashkangjitur gjithashtu literaturën e shfrytëzuar me 26 njësi bibliografike.

Qasja metodologjike në punim mbështetet në bazë shkencore-profesionale dhe të aplikueshme po ashtu nga ana praktike.

Në kapitullin e parë është dhënë abstrakti në të cilin është dhënë qëllimi kryesor i këtij studimi është të analizojë rolin e portit në ekonominë kombëtare dhe rajonale, si dhe të vlerësojë ndikimin e projekteve të fundit zhvillimore dhe investimeve të huaja në transformimin e tij.

Në kapitullin e dytë është dhënë historiku i qytetit, gjegjësisht portit të Durrësit.

Në kapitullin e tretë është dhënë roli i porteve në zhvillimin e transportit dhe ekonomik të shteteve me treguesit e performancës së porteve, modelet e qeverisjes dhe efikasiteti, qëndrueshmëria mjedisore dhe praktikata e sotme *“Green Port”*. Në këtë kapitull po ashtu është dhënë krahasim i portit të Durrësit me Portet rajonale dhe ato në botë sa i përket treguesve të prurjes, kohës së qëndrimit, produktivitetit, kohës së qëndrimit, digjitalizimit.

Në kapitullin e katërt është bërë analizë e infrastrukturës, supra-strukturës së portit si dhe teknologjisë për ngarkim-shkarkim në терминаlet e tyre.

Kapitulli i pestë ka për trajtim aspektin organizativ dhe operativ të porteve. Operatorët e rrjetit janë persona që përkujdesen për funksionimin e mirë të rrjetit të transportit ujor. Detyra e tyre kryesore është organizimi sa më i mirë i qarkullimit të anijeve në rrjetin ujor, monitorimin e transportit, analiza e të dhënave dhe në bazë të kësaj dhënie e propozimeve për përmirësimin e transportit, aplikimin e zgjidhjeve të reja, organizimin e ngarkim-shkarkimit të kontejnerëve nga anija dhe bartja e tyre,

Formulari – F3

veprimet në rast të aksidenteve, veprimet në rast të tollovide, etj. Roli i Global Navigation Satellite Systems (GNSS) në Portë dhe në veçanti në portin e Durrësit është dhënë në kapitullin e gjashtë. Në kapitullin e shtatë është theksuar rëndësia e përdorimit të teknologjisë “Cold Ironing”, “Elektrifikimi i pajisjeve” në drejtim të përkrahjes së konceptit “Green Port” si dhe roli i Digjitalizimit në efikasiteti e porteve.

Në kapitullin e fundit është dhënë përmbledhje e shkurtër e kapitujve të mëparshëm dhe rekomandimet në drejtim të rritjes së kapacitetit të portit të Durrësi si: optimizimi dhe ristrukturimi hapësinor, zhvillim i kapaciteteve inter modale, thellim i digjitalizimit dhe automatikës në port, mekanizmat për ngarkim dhe shkarkim, forcim i qeverisjes së koncesioneve, forum i përhershëm bashkëpunimi publike-privato.

Konkluzioni i Komisionit

Në bazë të vlerësimit të punimit të masterit me titull: **Analiza e efikasitetit të operacioneve në portet detare dhe ndikimi i tyre në zinxhirin e furnizimit – Studim rasti: Porti i Durrësit** i kandidatit *Bsc. Rinor Halimi*.

Konkluzion

Punimi i Masterit me titull **Analiza e efikasitetit të operacioneve në portet detare dhe ndikimi i tyre në zinxhirin e furnizimit – Studim rasti: Porti i Durrësit** i kandidatit *BSc. Rinor Halimi* i përmbush parakushtet metodologjike, profesionale-shkencore dhe etike të një punimi të nivelit Master. Punimit i është bashkëngjitur edhe Deklarata e studentit për punë autentike.

Prandaj, në mbështetje të Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe në mbështetje të Rregullores për studime Master, Komisioni për vlerësim, unanimisht dhe me kënaqësi i:

Propozon

Këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë, të miratojë Raportin për vlerësimin e punimit për Master me titull **Analiza e efikasitetit të operacioneve në portet detare dhe ndikimi i tyre në zinxhirin e furnizimit – Studim rasti: Porti i Durrësit** i kandidatit *BSc. Rinor Halimi*, dhe të bëjë procedimin e mëtejshëm, përkatësisht të formojë Komisionin për mbrojtje dhe të caktojë datën për mbrojtje publike të punimit.

Prishtinë: 15. 12. 2025

Komisioni:

1. Prof. **Ferat Shala**  -kryetar

2. Prof. asoc. **Arlinda Rrecaj**  -mentor,

3. Prof. asoc. **Shpëtim Lajqi**  - anëtar

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI INXHINIERISË MEKANIKE
Programi i studimit: Komunikacionit Rrugor
Niveli Master



PUNIM DIPLOME

**Analiza e efikasitetit të operacioneve në portet detare dhe
ndikimi i tyre në zinxhirin e furnizimit – Studim rasti:
Porti i Durrësit**

Studenti:

Rinor Halimi

Mentori:

Prof.Ass.Arlinda Rrecaj

Prishtinë, 2025

Contents

1	ABSTRAKTI	5
	LISTA E FIGURAVE	6
2	Hyrje.....	7
2.1.1	Historiku.....	8
2.1.2	Historiku i qytetit, port të Durrësit	8
2.1.3	Pozicioni.....	9
2.1.4	TRANSPORTI NË KOMUNIKACIONI.....	9
3	Transporti Detar (ujor)	10
3.1.1	Portet detare si nyje strategjike	12
3.1.2	Treguesit Kryesorë të Performancës së Porteve (KPI).....	13
3.1.3	Modelet e Qeverisjes dhe Efikasiteti.....	16
3.1.4	Qëndrueshmëria Mjedisore dhe Praktikat “Green Port”	17
3.1.5	Efikasitetit operacional.....	18
3.1.6	Përvoja Krahasuese nga Portet Rajonale.....	20
3.1.7	PORTET MË TË MËDHA NË BOTË	20
4	NGARKESAT TË CILAT VEPROJNË GJATË TRANSPORTIT	22
4.1	VEPRIMI I FORCAVE GJATË TRANSPORTIT NE MJETIN TRANSPORTUES 22	
4.2	NGARKESAT KLIMATIKE	24
4.2.1	Portet dhe Integrimi në Zinxhirët e Furnizimit	28
4.2.2	ANALIZA E TEKNOLOGJISË SË NGARKIM-SHKARKIMIT NË TERMINALET E KONTEJNERËVE TË PORTEVE	30
	PROCESI TEKNOLOGJIK I NGARKIM-SHKARKIMIT	30
	Procesi i ngarkimit varet nga:	30
5	ORGANIZIMI I PUNËS NË TERMINALET E KONTEJNERËVE TË PORTEVE NË LUMEJË.....	33
5.1	OPERATORET E RRJETIT NË TRANSPORTIN UJOR.....	33
6	Teknologjia dhe inovacioni në rritjen e efikasitetit.....	37
6.1	“GNSS (Global navigation satellite systems) ne porte”	38
6.2	Konstelacione të shumëfishta dhe sfidat e saktësisë dhe qëndrueshmërisë	38
6.3	6.3. Lundrimi bregdetar, afrimet e portit dhe rrugët ujore të brendshme.....	39
	Ankorim	40
	Pilotimi në port.....	40
	Gërmimi	40
6.4	Anije për qarkullim të lirë, kërkim dhe shpëtim	41
6.5	6.5.Mbikëqyrja dhe mbrojtja e mjedisit	42

6.6	Bregdetet	42
6.7	GNSS për Logjistikë dhe Operacione Portuale	44
6.8	Operacionet e terminalit të portit	45
6.8.1	APME+: Parimi	46
6.9	Zgjidhjet GPS / GNSS + INS	47
6.9.1	Rreth: GPS+INS dhe ku përdoret?	48
6.10	Sensori inercial IMU në sistemin GNSS/INS	49
6.11	Automatizimi i ruajtjes në natyrë	50
	Monitorimi i mallrave me vlerë të lartë	51
	Pozicionimi i saktë dhe i besueshëm për shumë aplikacione të tjera logjistike	52
	Përfitimet kryesore	52
7	Qëndrueshmëria Mjedisore dhe Praktikat e Porteve të Gjelbra	53
7.1	Sfidat dhe pengesat	53
7.2	Porti i Durrësit	54
7.2.1	Performanca Operacionale	55
7.2.2	Terminalet	56
7.2.3	Pajisjet	56
7.3	Korniza Institucionale dhe Qeverisja	56
7.3.1	Digjitalizimi dhe Inovacioni	57
7.3.2	Sfidat Kryesore	57
7.3.3	Pikat e Forta dhe Potenciali	57
	Ndikimi mbi Kostot Logjistike	58
	Ndikimi mbi Kohën e Dorëzimit	58
	Ndikimi mbi Besueshmërinë e Zinxhirit të Furnizimit	59
	Ndikimi mbi Konkurrueshmërinë Rajonale	59
	Rrjedhat Rajonale të Mallrave	60
7.3.4	Studime Krahasimore	60
7.3.5	Pasojat për Investitorët dhe Politikëbërësit	61
8	Përmbledhje	62
8.1	Rekomandime	62
	LITERATURA	63
	[6] Diplomarbeit, Containerlager im Inlandterminal-Eine Simulationsstudie der Servicehubanteile unter dem Einsatz von Basisstrategien, Wien, 2010.	63

DEKLARATA E AUTORSISË

Unë, i nënshkruari Rinor Halimi, deklaroj me përgjegjësi të plotë se ky Punim Diplome me titull "Analiza e efikasitetit të operacioneve në portet detare dhe ndikimi i tyre në zinxhirin e furnizimit – Studim rasti: Porti i Durrësit" është rezultat i punës sime origjinale kërkimore.

Të gjitha burimet e informacionit, literaturës, të dhënave dhe materialeve të tjera të përdorura gjatë këtij studimi janë cituar saktësisht dhe janë referuar në përputhje me standardet akademike. Ky punim nuk përmban materiale të kopjuara ose të plagjiatuara nga autorë të tjerë pa citimin e duhur.

Ky punim nuk është dorëzuar më parë në ndonjë institucion tjetër për marrjen e ndonjë grade shkencore ose titulli tjetër.

Studenti: Rinor Halimi

Nënshkrimi: _____

Data: Prishtinë, 2025

1 ABSTRAKTI

Ky punim diplome trajton analizën e transportit detar, rast studimi Porti i Durrësit, zhvillimin historik, ekonomik dhe strategjik të Portit të Durrësit, si një nga infrastrukturat më të rëndësishme detare në Shqipëri dhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Qëllimi kryesor i këtij studimi është të analizojë rolin e portit në ekonominë kombëtare dhe rajonale, si dhe të vlerësojë ndikimin e projekteve të fundit zhvillimore dhe investimeve të huaja në transformimin e tij.

Përfshirë analizën e të dhënave statistikore, janë përdorur metoda kërkimore cilësore, me aktorë institucionalë dhe studime krahasimore me porte të tjera të rajonit. Gjithashtu shqyrton sfidat kryesore me të cilat përballlet porti, si konkurrenca në tregun rajonal, logjistike problematike, ndikimet mjedisore dhe çështjet, e menaxhimit të qëndrueshëm.

Porti i Durrësit ka potencial të lartë për t'u kthyer në një qendër të rëndësishme tregtare dhe logjistike në Mesdhe, por kjo kërkon reforma strukturore, investime të vazhdueshme dhe përmirësim të menaxhimit operativ. Punimi përfundon me një sërë rekomandimesh për politikë publike dhe zhvillimin e qëndrueshëm të portit në të ardhmen.

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. <i>Porti detar</i>	10
Figura 2. <i>Porti Detar</i>	12
Figura 3. <i>Lidhja e transportit detar (Portit) me transportitn Hekurudhor</i>	13
Figura 4. <i>Lidhja e transportit hekurudhor me atë detar.</i>	14
Figura 5. <i>Porti i Durrësit</i>	15
Figura 6. <i>Porti i Durrësit</i>	16
Figura 7. <i>Porti i Roterdamit</i>	17
Figura 8. <i>Porti i Roterdamit</i>	18
Figura 9. <i>Porti i Durrësit</i>	19
Figura 10. <i>Portet më të mëdha në botë</i>	21
Figura 11. <i>Forcat e mundshme qe veprojnë gjatë transportit</i>	23
Figura 12. <i>Kondensimi ne kontejner</i>	24
Figura 13. <i>Rruga qarkulluese e ajrit në kontejner</i>	25
Figura 14. <i>Mënyra e vendosjes së ngarkesës ne kontejner</i>	26
Figura 15. <i>Konstruksioni i një kontejneri standard me trarë prej druri</i>	26
Figura 16. <i>Dy shtresa të trarit prej drurit</i>	27
Figura 17. <i>Sigurimi i ngarkesës ne kontejner</i>	28
Figura 18. <i>Ngarkimi me pesha të rënda anijet, transport për pesha të rënda.</i>	29
Figura 19. <i>Mekanizmat e ndryshme për ngarkim- shkarkim të kontejnerëve</i>	31
Figura 20. <i>Vinçi për ngarkim-shkarkim të kontejnerëve nga anija</i>	32
Figura 21. <i>Nder vinçi më i madh në botë</i>	32
Figura 22. <i>Operatoret e rrjetit</i>	33
Figura 23. <i>Operatoret e rrjetit ne port</i>	34
Figura 24. <i>Rrjeti i transportit</i>	35
Figura 25. <i>Rrjeti GNSS</i>	38
Figura 26. <i>Portet</i>	41
Figura 27. <i>Ngarkim-shkarkimi ne porte</i>	43
Figura 28. <i>Rrjeti GNSS i integrum ne oqean</i>	44
Figura 29. <i>Transmetuesi GNSS</i>	45
Figura 30. <i>Teknologjia Multipath</i>	46
Figura 31. <i>Moduleri Rxcontrol</i>	46
Figura 32. <i>Figura kur APME+ është i çaktivizuar (me blu) dhe kur është i aktivizuar (në të gjelbër)</i>	47
Figura 33. <i>Marresit GNSS/INS</i>	48
Figura 34. <i>Integrimi IMU/GNSS</i>	49
Figura 35. <i>Xhiroskopi</i>	49
Figura 36. <i>Veprimi i paisjeve bllokuese</i>	51
Figura 37. <i>Pjesëmarrja e Portit të Durrësit në totalin kombëtar (2024)</i>	55
Figura 38. <i>Përindja e të gjithë mallrave që hyjnë në Shqipëri</i>	55
Figura 39. <i>Krahasimi i portit të Durrësit me rajan të qëndrimit të kontinerit në ditë.</i>	59
Figura 40. <i>Produktiviteti i Vinçit</i>	60
Figura 41. <i>Koha mesatare e kthimit të anijes për orë</i>	60
Figura 42. <i>Trendi i kapacitetit të kontinerëve nga viti 2015-2023</i>	61

2 Hyrje

Ky punim studion në efikasitetin operacional të Portit të Durrësit dhe ndikimin e tij në zinxhirin kombëtar dhe rajonal të furnizimit. Për këtë qëllim, përdoren tregues të tillë si volumi TEU, tona ngarkesash, kohë qëndrimi dhe produktiviteti i molit/kranit. Gjithashtu, diskutohen sfidat me të cilat përballlet porti, si kapaciteti i kufizuar i tokës, ndryshimet e koncesioneve dhe investimet digjitale, dhe jepen rekomandime praktike për përmirësim.

Portet detare luajnë një rol thelbësor në zinxhirin global të furnizimit, duke shërbyer si pika hyrëse dhe daljeje për mallrat ndërkombëtare. Efikasiteti i operacioneve në porte ka një ndikim të drejtpërdrejtë në kohën e shpërndarjes, kostot e transportit dhe konkurrueshmërinë ekonomike të një vendi. Porti i Durrësit, si porti më i madh në Shqipëri, ka një rëndësi strategjike për tregtinë rajonale dhe ndërkombëtare.

Në kontekstin e globalizimit dhe rritjes së kërkesës për transport ndërkombëtar, efikasiteti i operacioneve portuale është bërë një faktor kyç për konkurrueshmërinë ekonomike. Për këtë arsye, është e rëndësishme të analizohen indikatorët, metodologjitë dhe praktikat më të mira në matjen e performancës së porteve. Ky studim gjithashtu shqyrton shembuj konkretë nga portet botërore dhe rajonale.

Porti i Durrësit, i vendosur në bregdetin Adriatik të Shqipërisë, është porta kryesore detare e vendit dhe përpunon më shumë se 75% të tregtisë detare të Shqipërisë. Ai shërben si një lidhje jetike edhe për vendet fqinje pa dalje në det, përfshirë Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut. Pozicioni i tij gjeografik e vendos atë përgjatë korridoreve kyçe evropiane, duke e bërë atë një rast studimi ideal për të kuptuar rolin e performancës së porteve në dinamikën e zinxhirëve të furnizimit. Efikasiteti i operacioneve në Portin e Durrësit ka implikime të rëndësishme si në nivel kombëtar ashtu edhe rajonal.

2.1.1 Historiku

Trafiku detar ose lundruer nënkupton lëvizjen e njerëzve dhe mjeteve të ndryshme në rrugë detare dhe lumore. Hapësirat oqeanike dhe detare janë të lira për lundrim, ndërsa ujërat territoriale paraqesin vazhdimin e pronësisë së një vendi në një zonë bregdetare.

Transporti detar është një nga më të vjetrit. Tashmë popujt parahistorikë përdornin anije me vela, ashtu si edhe popujt e vjetër dhe antikë. Nga shekulli i 14-të filloi periudha e përsosjes së anijendërtimitarisë për nevojat tregtare dhe ushtarake, sidomos për t'u mbrojtur nga korsarët e detit, të cilët plaçkitnin anijet tregtare. Në shekullin e 19-të, shpikja e motorrit me avull mundësoi një transformim rrënjësor në anijendërtimitarinë.

Një moment historik i rëndësishëm ishte viti 1807, kur për herë të parë në histori të botës filluan të qarkullojnë anije me avull, konkretisht "Clermont" e Fultonit, në lumin Hadson, duke lidhur Njujorkun me qytetin Albani. Një tjetër arritje e rëndësishme ishte kalimi i anijes "Savannah" prej 300 BRT, e SHBA-ve, përmes Atlantikut në vitin 1819, e shtyrë nga makina me avull dhe me vela, duke përfituar nga erërat që frynin në drejtim të Evropës. Në vitin 1827, anija "Curaçao" u bë anija e parë në botë që filloi të shfrytëzojë vetëm avullin.

2.1.2 Historiku i qytetit, port të Durrësit

Durrësi ka një histori 3,000-vjeçare dhe jeta e qytetit në shekuj lidhet ngushtë me portin e ndërtuar pranë tij.[19]

Ai është qyteti më i vlerësuar dhe i më përmendur nga autorët antikë, mesjetarë e modernë, gjeografë, historianë, poetë, filozofë, komediografë, arkeologë, vizitorë apo udhëtarë të ndryshëm.

Qyteti i banuar që në fillimet e tij nga Ilirët Taulantë njihet fillimisht me emrat Epidamn dhe Dyrrah, për të fituar më vonë emrin e sotëm në shqip, Durrës.

Megjithë pushtimet, luftërat apo tërmetet që e kanë goditur, Durrësi dhe porti janë ringritur në të njëjtin vend. [19]

Pas 3 mijëvjeçarësh jete të pandërprerë, Durrësi konsiderohet qyteti më i vjetër i bregut lindor të Adriatikut nga Vlora deri në Trieste, që vazhdon të mbijetojë.

Në Muzeun Arkeologjik Kombëtar të qytetit, më i madhi në vendin tonë, janë ekspozuar dëshmi të vijimësisë së jetës qytetare që nga fillimi i mijëvjeçarit të parë p.e.s., ndërsa zbulimet e fundit arkeologjike nënujore kanë provuar rëndësinë e portit në hapësirën detare Mesdhetare.

Relikte të anijeve të lashta, enë qeramike dhe spiranca të anijeve, që datojnë në periudha të ndryshme, deri prej 2,500 vitesh janë zbuluar kohët e fundit në afërsi të Durrësit, duke qartësuar edhe vektorët ekonomikë të shkëmbimeve tregtare detare mes qytetit dhe porteve të rajonit në antikitet dhe në mesjetë. [19]

Durrësi fiton një përmasë tepër të rëndësishme në shekullin e II-të të erës sonë, kur ndërtohet rruga "Egnatia" e cila bashkonte qytetet e perandorisë Romake me kolonitë e saj deri në Kostandinopojë (Stambolli I sotëm).

Rruga "Egnatia", që fillonte nga Durrësi, e ktheu qytetin në limanin më të rëndësishëm në brigjet e Mesdheut lindor.

Qyteti dhe porti pranë tij vijojnë ta ruajnë rëndësinë e tyre edhe në periudhën e mesjetës së hershme, dhe po ashtu edhe pas krijimit të shtetit të Arbërit. [19]

Pas pushtimit otoman, në fillim të shekullit të 20-të, porti i Durrësit rifiton gradualisht përmasën e tij ekonomike, edhe falë vendosjes në qytet të detarëve ulqinakë, që u zhvendosën nga Ulqini drejt porteve të Shqipërisë. [19]

Pas viteve 1950 Porti detar njohu një zhvillim të vrullshëm. Anijet e flotës tregtare, që lundronin nga Durrësi drejt porteve të oqeanit Indian dhe Atlantik transportonin mallra të ndryshme të përpunuara në port.

Edhe sot Durrësi ka pësuar transformime të mëdha si qytet, ndërsa porti është kthyer në një port të lirë komunikimi paqësor, që synon të lidhë vendet e Ballkanit me vendet e Europës së Bashkuar BE.

Bashkë me qytetin, edhe porti ka patur një progres të dukshëm, si në infrastrukturë edhe në teknologji, duke fituar gjithashtu edhe statusin e Autoritetit Portual, si mjaft porte të vendeve të BE. 19]

2.1.3 Pozicioni

Qyteti i Durrësit është i pozicionuar në pjesën veriore të gjirit me të njejtin emër (gjerësi gjeografike 41° 19' veri, dhe gjatësi gjeografike 19°27' lindje).

Ai ndodhet në bregun e detit Adriatik, në jug të qytetit, dhe në pjesën veriore të Gjirit të Durrësit. Ky gji detar është rreth 18 km i gjatë nga veriu në jug. Në perëndim te vijës ujore thellësia është më shumë se 10m.

Gjiri i Durrësit është i mbrojtur mirë prej erërave veri-perëndimore nga kepi i Durrësit, dhe nga kepi i Lagjit prej erërave jug-lindore.

Gjithashtu porti është i mbrojtur nga lindja dhe perëndimi nga dallgëthyesit e ndërtuar vite më parë.

Gjiri i Durrësit siguron një ankorim të sigurtë në radë, për anijet që presin të përpunohen në port.

2.1.4 TRANSPORTI NË KOMUNIKACIONI

Transporti është një proces i lëvizjes së njerëzve dhe mallrave nga dërguesi deri të pranuesi, duke bërë të mundur lëvizjen pa problem nga një vend në tjetrin. Transporti bëhet me mjetet e transportit që lëvizin nëpër rrugët transportuese.

Rrugët komunikuese janë rrugët e veçanta për mjete përkatëse (rrugët, hekurudhat, korridoret ajror dhe ujore).

Infrastruktura përcjellëse e komunikacionit përbëhet nga stacionet e udhëtarëve dhe të mallrave, portet, terminallet, aeroportet, stacionet e ngarkimit dhe shkarkimit, vendet e servisimit dhe remontit, sistemet për lidhje dhe sinjalizim etj.

Komunikacioni ofron (lidhe) shtete dhe kontinente, kontribuon në njohjen e njerëzve dhe racave, mundëson krijimin e vendbanimeve të reja, përfitimin e lëndëve të reja, përparimin dhe rritjen e prodhimtarisë të mirave materiale.

Komunikacioni ndahet në këto degë:

- Tokësor,
- Ujor,

- Ajror, dhe
- Postal.

Kurse në pikëpamje të sipërfaqes së rrugës ndahet në:

- Rrugor,
- Hekurudhor,
- Detar,
- Lumor,
- Liqen,
- Kanale,
- Tubacionit,
- Ajror, dhe
- Telekomunikacionit

3 Transporti Detar (ujor)

Transporti detar i mallrave, i njohur edhe si transport oqeanik, është një nga metodat më të vjetra dhe më të përdorura në botë për lëvizjen e mallrave. Është një komponent thelbësor i tregtisë globale, duke mundësuar transportin e sasive të mëdha të mallrave në distanca të gjata. Fig.1. Anija duke hyrë në port, ku vërehen mekanizmat e ngarkim shkarkimit.



Figura 1. *Porti detar*

Transporti ujqor është njëri ndër format më të vjetra të transportit sidomos për popujt e vendeve që kanë jetuar në afërsi të ujnave. Afro tri të katërtat (3/4) e tregtisë botërore kryhet përmes komunikacionit ujqor. Për lidhjen e kontratës për transportin detar të sendeve, mallrave dhe materialeve me rrugë detare, janë të nevojshëm transportuesi dhe pronari i ngarkesëspërfaqësues ose i autorizuar i tij si dërgues. Për këtë qëllim ekzistojnë edhe ndërmjetësues detar të cilët si veprimtari primare të vetën e kanë gjetjen e lidhjeve në mes të dërguesit dhe pronarit të anijes.

Karakteristikat kryesore të transportit detar janë të shumta dhe të rëndësishme. Një nga avantazhet më të mëdha është kapaciteti i lartë i anijeve të mallrave, të cilat mund të transportojnë tonelata të mëdha ngarkesash. Kjo e bën transportin detar ideal për vëllime të mëdha mallrash si nafta, gruri dhe makineritë.

Përveç kësaj, transporti detar është shumë më ekonomik se transporti ajror, veçanërisht për dërgesat jo urgjente dhe të rënda. Kjo është një arsye e rëndësishme pse shumë biznese zgjedhin transportin detar për të lëvizur mallrat e tyre.

Një tjetër avantazh i transportit detar është fleksibiliteti i tij. Ekzistojnë lloje të ndryshme anijesh, të cilat mund të përshtaten me lloje të ndryshme ngarkesash, duke përfshirë ngarkesat me shumicë, ngarkesat në kontejnerë dhe ngarkesat me madhësi të tepërt.

Në zhvillimet moderne, një nga ndryshimet më të mëdha ka qenë përdorimi i kontejnerëve të standardizuar. Kjo ka revolucionarizuar transportin detar, duke e bërë ngarkimin dhe shkarkimin më efikas dhe më të sigurt.

Transporti detar gjithashtu lidh tregjet ndërkombëtare përmes një rrjeti të gjerë rrugësh detare dhe portesh. Kjo i lejon bizneset të lëvizin mallrat e tyre në të gjithë botën në mënyrë efikas.

Portet shqiptare:

Në Shqipëri, transporti detar kryhet në katër porte kryesore: Durrës, Vlorë, Shëngjin dhe Sarandë. Fig.2. Një port ku shihen anijet e ngarkuara, foto e marrë nga interneti.



Figura 2. Porti Detar

3.1.1 Portet detare si nyje strategjike

Portet janë pika kyçe në zinxhirin e furnizimit global, duke lidhur transportin detar me mënyra të tjera të transportit si hekurudha dhe rrugët automobilistike. Sipas një raporti të UNCTAD nga viti 2022, mbi 80% e tregtisë botërore realizohet përmes porteve detare. Në nivel kombëtar, portet luan një rol të rëndësishëm në rritjen ekonomike duke nxitur eksportin, importin dhe investimet e huaja direkte.

Në fakt, portet janë më shumë se thjesht pika të shkarkimit dhe ngarkimit të mallrave - ato janë gjithashtu qendra të aktivitetit ekonomik që gjenerojnë vende pune dhe të ardhura për komunitetet lokale. Për më tepër, portet efikase dhe të mirë-menaxhuara mund të ndihmojnë në reduktimin e kostove të transportit dhe në përmirësimin e konkurrencës së vendeve në tregun global.

Në përgjithësi, portet janë një komponent kritik i infrastrukturës së transportit të një vendi dhe luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe në rritjen e mirëqenies së popullsisë.

Në nivel kombëtar, portet kontribuojnë në rritjen ekonomike duke nxitur eksportin, importin dhe investimet e huaja direkte.



Figura 3. Lidhja e transportit detar (Portit) me transportin Hekurudhor

Transporti detar prej kohësh është njohur si shtylla kurrizore e tregtisë ndërkombëtare.

3.1.2 Treguesit Kryesorë të Performancës së Porteve (KPI)

Për të vlerësuar efikasitetin e porteve, shpesh përdoren një grup treguesish kyç të performancës, të njohur si KPI. Këta tregues ndihmojnë në identifikimin e zonave që kërkojnë përmirësim dhe në vlerësimin e progresit me kalimin e kohës. Më poshtë janë disa nga KPI-të më të përdorur:

1. Koha e Qëndrimit të Anijeve (Vessel Turnaround Time): Kjo është koha mesatare që një anije kalon në port, nga mbërritja deri në nisje. Sa më e shkurtër kjo kohë, aq më efikase janë operacionet e portit.
2. Koha e Qëndrimit të Kontejnerëve (Container Dwell Time): Ky tregues mat kohën mesatare që një kontejner qëndron në terminal para se të merret nga transportuesi. Vlerat e larta të këtij

treguesi mund të tregojnë bllokime dhe joefikasitet në proceset doganore apo koordinimin logjistik.

3. Produktiviteti i Kalatave (Berth Productivity): Ky KPI mat numrin e kontejnerëve ose tonëve të ngarkuar/shkarkuar për vinç për orë. Një vlerë më e lartë tregon një efikasitet më të mirë në ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave.

4. Vëllimi i Përpunimit (Throughput): Ky tregues përfaqëson sasinë totale të mallrave ose TEU-ve (Twenty-foot Equivalent Unit) të përpunuar çdo vit. Përdoret shpesh për krahasimin e performancës ndërmjet porteve të ndryshme.

5. Kostoja e Shërbimit (Cost-to-Serve): Ky KPI mat koston logjistike si përqindje e vlerës së mallrave. Një vlerë më e ulët tregon një efikasitet më të mirë në menaxhimin e kostove.



Figura 4. Lidhja e transportit hekurudhor me atë detar.

Këta tregues janë thelbësorë për vlerësimin e performancës së porteve dhe identifikimin e mundësive për përmirësim.



Figura 5. *Porti i Durrësit*

Studiues si Notteboom dhe Rodrigue (2022) argumentojnë se edhe pse throughput përdoret shpesh si tregues kryesor, ai nuk përfaqëson të gjithë pamjen e efikasitetit. Portet e vogla mund të jenë shumë efikase për nga koha e qëndrimit dhe shërbimi i shpejtë, edhe pse përpunojnë vëllime më modeste. Prandaj, përdorimi i balancuar i KPI-ve është i domosdoshëm për të krijuar një pasqyrë reale të performancës.

3.1.3 Modelet e Qeverisjes dhe Efikasiteti

Një çështje tjetër e rëndësishme në literaturë është korniza institucionale dhe mënyra se si qeverisen portet.

Zakonisht, dallojmë 4 modele kryesore:

Modeli i Portit Shërbimor (Service Port Model): Autoriteti portual ka pronësinë dhe menaxhon të gjitha aktivitetet brenda portit.

Modeli i Portit me Mjete: Autoriteti përkujdeset për infrastrukturën, ndërsa kompanitë private mbajnë përgjegjësinë për operimin e superstrukturave, të tilla si vinçat dhe терминаlet.

Modeli i Portit Landlord (Landlord Port Model): Autoriteti portual vepron si rregullator dhe pronar toke, duke dhënë терминаlet me qira për operatorë privatë që merren me operacionet e përditshme.

Modeli i Portit Privat: Privatizim i plotë i aseteve dhe operacioneve portuale.

Studimet empirike sugjerojnë se modeli landlord, i kombinuar me partneritete publike-private (PPP), arrin nivelet më të larta të efikasitetit (World Bank, 2022). Portet si Roterdami, Antverpi dhe Pireu kanë përfituar nga ky model, ku investimet private çojnë modernizimin përpara ndërkohë që shteti ruan kontrollin rregullator.



Figura 6. Porti i Durrësit

3.1.4 Qëndrueshmëria Mjedisore dhe Praktikak "Green Port"

Literatura moderne mbi efikasitetin portual ka zgjeruar fokusin e saj për të përfshirë aspektet mjedisore. Portet, në veçanti, janë identifikuar si burime të mëdha të emetimeve të CO₂, zhurmës dhe ndotjes së ujit. Kjo ka bërë që efikasiteti të mos matet më vetëm në terma operacionalë, por edhe në mënyrën se si burimet përdoren në mënyrë të qëndrueshme. Koncepti i Portit të Gjelbër (Green Port) thekson efikasitetin energjetik, përdorimin e energjive të rinovueshme dhe përputhshmërinë me rregulloret mjedisore si ato të përcaktuara nga IMO2020.



Figura 7. Porti i Roterdamit

Një shembull tërheqës është ai i Portit të Roterdamit, i cili ka investuar ndjeshëm në teknologjitë e furnizimit me energji elektrike nga bregu, të njohura si "shore power". Kjo zgjidhje i lejon anijet të fikin motorët e tyre gjatë ankorimit, duke reduktuar ndjeshëm emetimet. Në të njëjtën linjë, portet skandinave si ai i Goteborgut dhe Oslo-s kanë adoptuar praktika të qëndrueshme mjedisore, duke integruar përmirësimet e efikasitetit me iniciativat e gjelbra. Kjo qasje jo vetëm që redukton ndikimin mjedisor, por gjithashtu promovon një ekonomi më të qëndrueshme dhe konkurruese.

Për Durrësin dhe portet e tjera të Ballkanit, përshtatja me standardet mjedisore të BE-së është njëkohësisht sfidë dhe mundësi. Projektet e modernizimit janë gjithnjë e më shumë të lidhura me përputhshmërinë ndaj kërkesave të qëndrueshmërisë, duke reflektuar kushtet e anëtarësimit në BE.



Figura 8. Porti i Roterdamit

3.1.5 Efikasitetit operacional

Indikatorët kryesorë përfshijnë:

- Koha mesatare e qëndrimit të anijes në port.
- Produktiviteti i vinçave (TEU/orë).
- Shfrytëzimi i kapacitetit të terminaleve.
- Koha e përpunimit të kontejnerëve.
- Kostot operative për njësi mallrash.

Këta indikatorë lejojnë krahasimin ndërmjet porteve dhe identifikimin e dobësive. Treguesit Kryesorë të Performancës së Efikasitetit të Portit.

Matja e efikasitetit zakonisht mbështetet në një sërë Treguesish Kryesorë të Performancës (KPI). Këto përfshijnë:

1. Koha e Përpunimit të Anijes – koha mesatare që një anije kalon në port nga mbërritja në nisje. Kohët më të shkurtra të përpunimit tregojnë operacione më efikase.

2. Koha e Qëndrimit të Kontejnerëve – koha mesatare që një kontejner qëndron në terminal para se të merret. Kohët e gjata të qëndrimit pasqyrojnë mbingarkesën dhe joefikasitetin në koordinimin doganor ose logjistik.

3. Produktiviteti i Ankorimit – numri i kontejnerëve ose toneve të ngarkesës së trajtuar për viç në orë.



Figura 9. *Porti i Durrësit.*

4. Produktiviteti – vëllimi total i ngarkesës ose TEU-të e trajtuara çdo vit, shpesh përdoren për të krahasuar portet e madhësive të ndryshme.

5. Kostoja për Shërbim – kostoja logjistike si pjesë e vlerës së ngarkesës.

Studiues si Notteboom dhe Rodrigue (2022) argumentojnë se ndërsa prodhimi shpesh përdoret si një tregues kryesor, ai nuk e kap plotësisht efikasitetin. Portet më të vogla mund të jenë shumë efikase për sa i përket kohës së qëndrimit dhe përpunimit edhe nëse prodhimi i tyre është modest. Prandaj, një përdorim i balancuar i KPI-ve është i nevojshëm për të ofruar një pamje të saktë të performancës.

3.1.6 Përvoja Krahasuese nga Portet Rajonale

Për të vendosur rastin e Durrësit në kontekst, është e rëndësishme të rishikohen literaturat mbi portet e rajonit.

- Pireu (Greqi): Që nga privatizimi nën COSCO, Pireu është shndërruar në një nga portet me rritjen më të shpejtë në Evropë, duke kaluar 5 milionë TEU çdo vit. Studimet ia atribuojnë këtë sukses investimeve të mëdha private, automatizimit dhe integritit me iniciativën “Belt and Road” (Cullinane, 2021).

- Selanik (Greqi): Pas dhënies me koncesion operatorëve privatë, Selaniku ka përmirësuar ndjeshëm kohën e qëndrimit të anijeve dhe ka zgjeruar lidhjet me hinterlandin.

- Rijeka (Kroaci): Duke përfituar nga financimet e BE-së, Rijeka ka modernizuar терминаlet dhe ka zgjeruar kapacitetin, duke u pozicionuar si një port kyç i Adriatikut.

- Bar (Mali i Zi): Megjithëse me kapacitet më të vogël, Bar ka arritur të ruajë efikasitetin përmes thjeshtimit të procedurave doganore dhe integritit rajonal me rrugët dhe hekurudhat. Në krahasim, Durrësi mbetet prapa në modernizim dhe integrim. Literatura tregon se pa reforma të thella, ekziston rreziku që zinxhirët rajonalë të furnizimit ta anashkalojnë atë në favor të alternativave më efikase.

Krahasimi me Portet Rajonale

Treguesi	Durrës	Pireu	Selanik	Rijeka	Bar
Throughput (TEU, 2023)	150,000	5,000,000	450,000	350,000	70,000
Koha e Qëndrimit (orë)	36–40	12–18	18–22	20–24	24–30
Produktiviteti (moves/orë)	15–20	30–35	25–28	22–26	15–18
Dwell Time (ditë)	6–8	3–4	4–5	3–4	5–6
Lidhjet Hekurudhore	Të kufizuara	Shumë të forta	Mesatare	Shumë të forta	Të dobëta
Digjitalizimi	I ulët	Shumë i lartë	I mesëm	I mesëm	I ulët


Ky krahasim tregon qartë se Durrësi ka diferenca të mëdha në pothuajse çdo tregues operacional, pra është shumë i vogël për kapaciteti dhe më nivel i dobët. Megjithatë, për shkak të pozicionit strategjik, ai ende mbetet porti kryesor i Shqipërisë dhe një nyje e rëndësishme rajonale.

3.1.7 PORTET MË TË MËDHA NË BOTË

Ne vazhdim janë paraqitur portet më të mëdha në botë varësisht ngathëllësia e anijes në ujë (pjesa e anijes në kontakt me ujë).

Ndarja e porteve është bërë sipas thellësisë së anijes në ujë:

- 14.5 (m), deri 8.000 TEU,
- 16.0 (m), deri 11.000 TEU, dhe
- 18.0 (m), deri 18.000 TEU



BURIMI: MENAXHIMI I KONTEJNERËVE (2010)

Figura 10. *Portet më të mëdha në botë*

4 NGARKESAT TË CILAT VEPROJNË GJATË TRANSPORTIT

4.1 VEPRIMI I FORCAVE GJATË TRANSPORTIT NE MJETIN TRANSPORTUES

Mënyra ngarkimit të mjetit transportues duhet të realizohet në atë mënyrë që të i përballojë të gjithë forcat që veprojnë gjatë transportit ujor dhe rrugorë. Kontejnerët e mbyllura, pamundësojnë një kontroll gjatë transportit. Një përmirësim ose ndryshim të sigurimit të ngarkesave nuk mund të realizohet nëse kontejneri është i mbyllur. Prandaj firmat (kompanit) që merren me ngarkim e mallrave në mjetin transportues duhet të kenë njohur lidhur me forcat që paraqiten gjatë transportit. Zakonisht dallohen dy lloje të forcave mekanike.

Forcat statike paraqiten gjatë vendosjes dhe qëndrimit të ngarkesave në dyshtet e kontejnerit. Si faktor kryesor është shtypja e cila krijohet gjatë vendosjes së mallrave njëra mbi tjetrën. Kjo shtypje varet nga masa, forma dhe lartësia e ngarkesave të vendosura njëra mbi tjetrën.

Forcat dinamike paraqiten gjatë ngarkimit të kontejnerit, transportit rrugor dhe ujor si dhe gjatë zhvendosjes së kontejnerit. Kjo forcë varët nga shpejtimi, forcat vibruese dhe goditëse. Shpejtimi dhe goditjet paraqiten gjatë ngarkimit, frenimit, lëvizjes nëpër përparëza, në të poshtëza si dhe lëvizja nëpër kthesa. Kurse gjatë transportit ujor, shpejtimi paraqitet gjatë lëvizjeve vertikale dhe rrokullisëse. Vibracionet paraqitet nga motori i anijes, rruga dhe binaret sipërfaqësore.

Konstanta e nxitimit të gravitetit të tokës e shfrytëzuar në figurën 2.1, është:

$$g = 9.81 \frac{\text{m}}{\text{s}^2} \dots$$

Është e mundur që nxitimi gjatë goditjeve të vogla ose vibracioneve të këtyre vlerë më të lartë së ajo e cekur më lartë.






Figura 11. Forcat e mundshme qe veprojnë gjatë transportit

4.2 NGARKESAT KLIMATIKE

Gjatë transportit, ngarkesat duhet të përballojnë kushte të ndryshme klimatike. Ngarkesat paraqiten qe nga deponimi si dhe ngarkimi i tyre në kontejner. Pastaj këto ngarkesa paraqiten gjatë ndryshimeve të ndryshme klimatike gjatë transportit tokësor e sidomos gjatë zonave të ndryshme klimatike gjatë transportit ujor. Kontejnerët e mbyllur mbrojnë ngarkesat e brendshme nga kushtet e ndryshme klimatike siç, janë: shiu, bora, uji i kriper, mjegulla si dhe nga rrezatimet UV¹ nga dielli. Edhe pse kontejnerët mbrojnë nga kushtet ekstreme klimatike, në brendësi të tyre të mund të formohet kondensimi. Lagështia relative ajrore në kontejner, do të ndikoj në temperaturën aktuale të kontejnerit nga lagështia e cila formohet gjatë ngarkimit të ngarkesës në kontejner. Burimet e lagështisë mund të paraqiten nga ajri i mbyllur në kontejner, nga vetë ngarkesa, dhe nga paketimi i tyre. Kondensimi së pari paraqitet ne muret e kontejnerit, pastaj fillon të bie në ngarkesë. Pasojat të cilat paraqiten nga kjo dukuri janë: ndryshku, njolla, myku, ngjitja e kartonëve të lagur, largimi i mbishkrimeve ose shembja e ngarkesave të vendosura njëra mbi tjetrën.



Figura 12. *Kondensimi ne kontejner*

Në figurën 11.3 janë paraqitur rrugët ajrore në kontejner




Figura 13. Rruga qarkulluese e ajrit në kontejner

- 1) Mënyra jo e rregullt e vendosjes së ngarkesave, me çka është mbyllur rruga qarkulluese e ajrit ne kontejner.

Në figurën 11.4 është paraqitur ndikimi i rrezatimit UV ne ngarkesat e vendosura ne kontejner




Figura 14. *Mënyra e vendosjes së ngarkesës ne kontejner*

Mënyra e vendosjes së trarëve prej druri në kontejner për shpërndarje konstantë të ngarkesave në dyshemenë e kontejnerit është paraqitur në fig. 11.5




Figura 15. *Konstruksioni i një kontejneri standard me trarë prej druri*

Tabela 11.1 Dimensionet minimale për vendosjen e trarëve të drurit në kontejner, dimensionet në cm.

Tipi i kontejnerit		20'	40'
A	Gjerësia minimale e trarit prej druri (cm)	10	15
B	Distanca minimale tërthore të mesit të kontejnerit (cm)	40	40

Në disa raste kur ngarkesa ka masë më të madhe dhe që të mos tejkalohet kufiri i lejuar i ngarkesës mbi trarin e vendosur në dyshemenë e kontejnerit mund të vendoset edhe një trarë shtesë mbi të në formë tërthore, fig. 11.6.




Figura 16. *Dy shtresa të trarit prej drurit*

Në rastin kur më trarin prej druri nuk mund të realizohet shpërndarja konstante në dyshemenë e kontejnerit, atëherë duhet të shfrytëzohen kontejnerët me një konstrukcion më të fort të dyshemesë.

Në figurën 11.7 janë paraqitur disa mënyra se si mund të behet fiksimi i ngarkesave, me qëllim që të mos kemi dëmtim të ngarkesave gjatë transportit.




Figura 17. Sigurimi i ngarkesës ne kontejner

4.2.1 Portet dhe Integrimi në Zinxhirët e Furnizimit

Literatura për menaxhimin e zinxhirëve të furnizimit thekson se duhet të shohet porta si pjesë përbërëse e sistemeve logjistike. Portat efikase zvoglojnë kostot totale logjistike, derisa portat

joefikase nderojnë kostot e inventarit, krijojnë pasiguri dhe minojnë sistemet e prodhimit ne kohë.

Rodrigue (2020) thekson se në zinxhirët e furnizimit botëror, besueshmëria e nyjeve logjistike është shpesh më rëndësishme sesa kostoja. Vonesat në porte mund të përhapen përgjatë zinxhirit të furnizimit dhe të shkaktojnë rritjen e kostove të mbajtjes së inventarit dhe ndërprerje të prodhimit.



Figura 18. Ngarkimi me pesha të rënda anijet, transport për pesha të rënda.

Për Shqipërinë dhe fqinjët e saj, kjo do të thotë se joefikasitetet në Durrës nuk rrisin vetëm kostot logjistike, por dëmtojnë edhe konkurrueshmërinë e industrive që varen nga importet dhe eksportet me kohë të përcaktuar, si prodhimi, ndërtimtaria dhe agro-biznesi.

4.2.2 ANALIZA E TEKNOLOGJISË SË NGARKIM-SHKARKIMIT NË TERMINALET E KONTEJNERËVE TË PORTEVE

PROCESI TEKNOLOGJIK I NGARKIM-SHKARKIMIT

Zhvillimi i teknikes, teknologjisë, i mjeteve të transportit dhe sistemeve të transportit multimedial ka ndikuar ne zhvillimin e procesit të ngarkimit dhe shkarkimit.

14.1 Procesi i ngarkimit

Ngarkimi i mallit në mjetin transportues ngarkon efektin e transportit dhe varet nga teknologjia e përdorur. Teknologjitë klasike të transportit, procesi i ngarkimit i veçantë ngarkon dukshëm gjatë më së shpeshti për besimin në teknologjitë bashkëkohore ku procesi i ngarkimit është relativisht i shkurtër dhe ka trend të zvogëlimit.

Processimi dhe ngarkimi i mallit në një mjet transportues e përcjell aktivitetet e qe te ndëshkohen këto duhet të bashkohen elementeve të ngarkimit. Në rënd të parë është të mendohet në sigurimin e mallit, ngarkesës të ngarkuar.

Ego ngarkim bën kuptimin e përgatitjes së mjetit transportues, të organizimit të vendit të ngarkimit, të caktimit të llojit të ngarkimit dhe të formimit të dokumentacionit përcjellës të mallit qe transportohet.

Procesi i ngarkimit varet nga:

- *lloji i ngarkesës,*
- *lloji i paketimit,*
- *pajisjet ngarkuese,*
- *infrastruktura, dhe*
- *logjistika.*

14.2 Procesi i shkarkimit

Procesi i shkarkimit nënkupton lëshimin e ngarkesës nga mjeti transportues në vendin për shkarkim më dokumentacionin përcjellës.

Procesi i shkarkimit varët nga:

- *lloji i ngarkesës,*
- *lloji i paketimit,*
- *pajisjet shkarkuese,*
- *infrastruktura, dhe*

- *logjistika.*

Ekzistojnë mekanizmat e ndryshme për ngarkim- shkarkim të kontejnerëve nga anija, të cilët janë paraqitur ne vazhdim.



Figura 19. *Mekanizmat e ndryshme për ngarkim- shkarkim të kontejnerëve*

Vinçat portal (Gjer. Kaikran, Ang. Quay Crane, QC)

Janë të vendosura në mes të anijes dhe hapësirës ku vendosen kontejnerët. Konstruksioni i tyre mundëson lëvizjen e tyre nëpër binar. Performancat teknike të këtyre kontejnerëve mundësojnë një ngarkim ose shkarkim prej 50-60 kontejnerëve në orë (50-60 kontejner/h).



Figura 20. Vinçi për ngarkim-shkarkim të kontejnerëve nga anija




Figura 21. Nder vinçi më i madh në botë

5 ORGANIZIMI I PUNËS NË TERMINALET E KONTEJNERËVE TË PORTEVE NË LUMEJË

5.1 OPERATORET E RRJETIT NË TRANSPORTIN UJOR

Operatorët e rrjetit janë persona që përkujdesen për funksionimin e mirë të rrjetit të transportit ujor. Detyra e tyre kryesore është organizimi sa më i mirë i qarkullimit të anijeve në rrjetin ujor, monitorimin e transportit, analiza e të dhënave dhe në bazë të kësaj dhënie e propozimeve për përmirësimin e transportit, aplikimin e zgjidhjeve të reja, organizimin e ngarkim-shkarkimit të kontejnerëve nga anija dhe bartja e tyre, veprimet në rast të aksidenteve, veprimet në rast të tolloive, etj.

Njohja e transportit, rrjetit të transportit, mjeteve transportuese që qarkullojnë, teknologjive të reja që aplikohen por edhe ligjshmërive të qarkullimit në transportin ujor e cila është shumë e rëndësishme për kryerjen me sukses të punëve të tyre. Përgjegjësia e punës së tyre është e lartë.




Figura 22. *Operaret e rrjetit*

Operatorët e rrjetit përdorin sistemet e ndryshme informative që ndërlidhin harduerin-sistemet kompjuterike dhe pajisjet e ndryshme që aplikohen në transportin ujor, dhe softuerin- programet kompjuterike të ndryshme të rrjetit të transportit ujor për të realizuar funksionimin, rregullimin, kontrollimin, monitorimin, organizimin, riorganizimin dhe

analizën e rrjetit të transportit dhe punës në port.



Figura 23. Operoret e rrjetit ne port

Operoret e rrjetit të transportit ujon përdorin sistemet informative për të mbledhur informatat, përpunuar të dhënat nga këto informata, analizuar dhe studiuar të dhënat dhe pastaj marrin vendimet për ndryshimin, përmirësimin apo intervenimin në transportin dhe punën në port që po zhvillohet

Karakteristikat e përgjithshme të sistemeve të tilla janë:

- *Mbështetja në bazat e të dhënave të specializuara,*
- *Informacion mbi të gjitha format alternative të transportit,*
- *Vizualizimi i të dhënave, etj.*




Figura 24. Rrjeti i transportit

Mësime nga Praktikrat më të Mira Ndërkombëtare

Literatura ofron gjithashtu mësime nga praktikrat më të mira ndërkombëtare:

- Automatizimi:** Terminalët plotësisht të automatizuar, si ato në Rotterdam dhe Shangai, arrijnë produktivitet më të lartë.
- Port Community Systems:** Platformat digjitale të integruara reduktojnë kohën e qëndrimit dhe përmirësojnë koordinimin.
- PPP-të:** Kapitali dhe ekspertiza private mund të përshpejtojnë modernizimin.
- Lidhja me Hinterlandin:** Integrimi me hekurudhë dhe rrugë siguron që përmirësimet në port të përkthehen në efikasitet logjistik.
- Praktikat e Gjelbra:** Qëndrueshmëria po lidhet gjithnjë e më shumë me konkurrueshmërinë, pasi ngarkuesit preferojnë porte me përgjegjësi mjedisore.

Korniza teorike

Në të kaluarën në literaturën e menaxhimit të operacioneve, efikasiteti është përkufizuar si raporti ndërmjet inputeve dhe outputeve. Në portet detare, kjo do të mbëdhenti në shfrytëzim optimal të burimeve fizike, njerëzore dhe teknologjike.

Të gjitha studimet e Notteboom dhe Rodrigue (2020) në funksionimin e portit theksojnë se portet janë organizata komplekse ku faktorët ekonomikë, teknologjikë dhe institucionalë afrohen direkt në performancën e tyre.

Modelet e menaxhimit portual dalin nga menaxhimi tradicional deri tek automatizimi i plotë i terminaleve.

Portet detare dhe strategjike

Portet formojnë pikat e fllën në një furnizim nënshtrirëse global. Ato përbind transportin detar me modalitete të tjera si hekurudha dhe rrugë automobilistike. Secokinojobet e UNCTAD (2022), më shumë se 80% e tregtisë botërore realizohet nëpërmjet porteve detare.

Në nivel kombëtar, portet nënkontribojnë për rritjen ekonomike duke shpejtuar eksportin, importin dhe investimet e huaja direkte.

Analizë krahasuese ndërkombëtare

Portit e Rotterdam-it është vlerësuar si një nga më të efikasit në Evropë për grumbullim të pasurive elektronike dhe infrastrukturave të elektrifikuar.

Në Azinë, porti i Shangai dhe porti i Singapuri kontrollon botërinë të tregtimi për nga pasuria dhe shpejtësia në përpunim.

Kënaqëm gjëndet në menyra të komparuara me ata portet e Mesdheut dhe Ballkanit mungojnë automatizimi dhe logjistikë, por përfshijnë pasurë zhvillimi nëpërmjet investimeve.

6 Teknologjia dhe inovacioni në rritjen e efikasitetit

Terminal automatization dhe përdorimi i sistemave të menaxhimit të logjistikës përmirëson kohën e përpunimit.

Artificial intelligence dhe Big Data permitojnë parashikimin e kërkesës dhe optimizimin e burimeve.

Gelb portet, që përdorin energji të rinovueshme dhe teknologji miqësore me mjedisin, janë duke bërë standard i ri në industrinë detare.

Në dekadën e mëvonshme, dixhitalizimi është ekzistuar si një determinues qendror i efikasitetit të porteve. Teknologji të tilla si Sistemet e Komunitetit Portual (PCS), blockchain, gjurmimi i ngarkesave në kohë reale dhe pajisjet e automatizuara të terminalit kanë ndryshuar mënyrën se si funksionojnë portet. Në OECD (2021), portet që adoptonin sisteme dixhitale thellësojnë kohën e pritjes së anijeve deri në 30% dhe kohën e qëndrimit të kontejnerëve me 25%.

rasteve aziatike and evropiane studies paint this revolution. Port i Singaporit has been a leader in the deployment of binjake dixhitale technology for simulation and optimization in real-time of operations. In Evropë, Port i Hamburgut has adopted PCS that consolidates lines of transport detar, doganat dhe logjistikë ofruesit into a single dixhitale platform, eliminating sensitively dokumentacionin dhe vonesat.

Në të kundërt, shumë porte të vendeve në zhvillim, përfshirë ato në Ballkanin Perëndimor, mbeten prapa në miratimin dixhital. Studimet tregojnë se mungesa e dixhitalizimit është një nga shkaqet kryesore të mbingarkesës, vonesave dhe kostove të larta të logjistikës (Wilmsmeier & Monios, 2022).

Në dekadën e vogël, digjitalizimi është ekzistuar si një determinant qendror i efikasitetit portual. Teknologji ka futur Port Community Systems (PCS), voja në kohë reale të ngarkesave dhe pajisjet automatizuar të terminalit kanë reshurse mënyrën se si funksionojnë portet. Siç vërtetohen OECD (2021), portet që adoptojnë sisteme digjitale reduktojnë kohën e pritjes së anijeve deri në 30% dhe kohën e qëndrimit të kontejnerëve deri në 25%.

Shembuj praktikë nga portet aziatike dhe evropiane e ilustronjë këtë transformim. Porti i Singaporit ka qenë pionier në përdorimin e teknologjisë “digital twin”, që lejon simulim dhe optimizim në kohë reale të operacioneve. Në Evropë, Porti i Hamburgut ka zbatuar PCS që integron linjat detare, doganat dhe operatorët logjistikë në një platformë të vetme digjitale, duke reduktuar ndjeshëm dokumentacionin dhe vonesat.

Në kontrast, shumë porte të vendeve në zhvillim, përfshirë ato të Ballkanit Perëndimor, mbeten prapa në adoptimin e digjitalizimit. Studimet tregojnë se mungesa e digjitalizimit është një nga shkaqet kryesore të kongjestionit, vonesave dhe kostove të larta logjistike (Wilmsmeier & Monios, 2022). [20]

6.1 “GNSS (Global navigation satellite systems) ne porte”

Industria detare ishte e shpejtë për të adoptuar navigimin satelitor dhe rreth 87% e transportit tregtar tashmë përdor sisteme globale satelitore për navigim dhe pozicionim. Rreth 90% e tregtisë botërore kryhet nga deti, dhe transporti detar përbën rreth 40% të tregtisë midis vendeve të BE-28.

Për më tepër, ka më shumë se 50,000 anije tregtare mbi 1000 GRT (ton bruto të regjistruar) që tregtojnë ndërkombëtarisht. Dhe, çdo vit, rreth 400 milionë pasagjerë përdorin portet evropiane. Me anije më të mëdha që kushtojnë mbi 100 milionë euro për t'u ndërtuar dhe VLCC (ngarkesa në transportues shumë të mëdhenj të papërpunuar) me vlerë mbi 200 milionë euro, aksionet për sigurinë, sigurinë dhe efikasitetin janë të larta.

Si rezultat, tani ka një interes në rritje të shpejtë për potencialin e madh të GNSS për përdoruesit e mjeteve të kohës së lirë, lundrimin bregdetar, operacionet e kërkimit dhe shpëtimit dhe lundrimin në rrugët ujore të brendshme - veçanërisht në lidhje me një sistem shtimi të bazuar në hapësirë (SBAS) si ai evropian Shërbimi i Mbivendosjes së Navigimit Gjeostacionar (EGNOS).[22]




Figura 25. Rrjeti GNSS [20][21]

6.2 *Konstelacione të shumëfishta dhe sfidat e saktësisë dhe qëndrueshmërisë*

